



**Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh dhe stafi të UPT-së  
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus +  
në University of Applied Sciences në Nysa, Poloni**

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët dhe stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, **Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës**, në University of Applied Sciences, në Nysa, Poloni.

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime (SMS- Students mobility for studies).
- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie.

**Nivelet e mobilitetit për studentët:** Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi, në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës dhe të kenë përfunduar një vit akademik.

**Kohëzgjatja e bursës për studentët:** 1 semestër, semestri i dytë i vitit akademik 2023 – 2024.

**Fushat e studimit:** Arkitekturë dhe Urbanistikë

**Numri total i studentëve:** 1 student

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj\*;
- Dokumenti Learning Agreement\*\*.

*\*Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B1. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

*\*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Mobility Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Applied Sciences In Nysa, Poloni, lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.*

*Dokumenti “Learning Agreement” të seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

*Për të shkarkuar formatin e “Learning Agreement” klikoni më poshtë:*

[ANEKS 2 - Mobility-agreement-studies, student.pdf \(upt.al\)](#)



**Key Action 1  
– Mobility for learners and staff –**

*Për të parë listën e lëndëve dhe për të marrë informacion të përgjithshëm rreth studimeve në Applied Sciences in Nysa, Poloni, ju lutemi klikoni te link-u::*

<https://pans.nysa.pl/org/ico/blog/uas-in-nysa-international-summer-programme-1>  
<https://pans.nysa.pl/uploads/bwm%20ENG/pliki/int%20summer%20prog%20new.pdf>

Studenti i përzgjedhur duhet të marrë pjesë në 1 kurs (4 ECTS) në UAS tonë në Programin Ndërkombëtar Veror Nysa, që do të organizohet në datat 1-14.07.2024.

Linku i kursit: <https://pans.nysa.pl/org/ico/blog/uas-in-nysa-international-summer-programme-01-07-12-07-2024>

**Kohëzgjatja e bursës për stafin:** 5 + 2 ditë, gjatë vitit akademik 2023 - 2024

**Fushat e studimit:** Arkitekturë dhe Urbanistikë

**Numri total i stafit akademik për mësimdhënie:** 1

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës, për stafin akademik;
- Plani i propozuar i lëvizshmërisë, "Staff Mobility for Teaching, Mobility Agreement".
- Të paktën një nivel B2 të gjuhës angleze

Për të shkarkuar formatin e "Staff Mobility for Teaching, Mobility Agreement" klikoni te: [Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](#) , aneks 4.

**Afati për aplikim: Deri më 29 shtator 2023, ora 12.00**

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al) , [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al) .